



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME
KORÇË

Nr 289 prot

Korçë më 15.09.2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 759 , datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Përbërjen e Njësise së Zhvillimit të Institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar,

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

Mësues të Teorisë dhe/ose Praktikës Profesionale me kohë të pjesëshme, për "Drejtimin Veterinari"
1 (Një) mësues me normë mësimore javore 9 orë.

1. Kriteret e përgjithëshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësues të Teorisë dhe/ose Praktikës Profesionale në Shkollën Profesionale Shërbime Korçë janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizje paralele si vijon :

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- ë) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimi

Aplikanti duhet të plotësoje Kriteria të posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë të niveli Master profesional ose të barazvlefshëm me të , në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit , e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :

- a) Letër motivimi për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 të këtij udhëzimi
- c) Kartën e identitetit,
- d) Diplomën
- e) Librezën e punës
- ë) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
- f) Çertifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- gj) Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
- i) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës.....24.09.2026

3. Vlerësimi I kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr 759 ,datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë menaxhimin e Burimeve Njerëzore,Përbërjen e Njësise së Zhvillimit të Institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar,

